



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2217/1 Prot

Tiranë, më 16/09 /2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____
DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr.11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.190/1 prot, datë 08.09.2020 “Njoftim lëvizje paralele” të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë, protokolluar në AKPA me nr.2217 prot, datë 10.09.2020

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale, në Shkollën e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë, për pozicionet:

- a) 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, Specialist marketingu dhe turizmi, me kohë të plotë;
- b) 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, Kimist/Merceolog, me kohë të plotë.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë, si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2.Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 18.09.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë, të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- a) 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, Specialist marketingu dhe turizmi, me kohë të plotë;
- b) 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, Kimist/Merceolog, me kohë të plotë.

në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm” Tiranë brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm” Tiranë, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm” Tiranë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

